

*Cyrih, Mars 2017*

## **Sprehuni edhe ju – Mundësit e juaja për pjesëmarrje në diskutime**

*Mundësit e pjesëmarrjës në politik me ose pa shtetsinë zvicerane në qytetin e Cyrihut*

Në qytetin e Cyrihut ekzistojn shumë mundësi, se si mund të angazhoheni në krijimin e mendimeve – dhe procesin e vendimeve politike. Me një pjesëmarrje aktive në keto procese ju mund të kontribini në formimin e qytetit Cyrih, si dhe në një jetesë të mirë të përbashkët. Pjesëmarrja juaj është e mirëpritur.

### ***Ju keni një ide për përmirësimin e jetesës të përbashkët***

Zyra të ndryshme të qytetit mund të ju këshillojnë për realizimin, si për shembull koordinimi i lagjës ose përkrahja për integrimi qytetit Cyrih. Veçanërisht të mirëpritur janë **angazhimët** dhe projektët e qytetarve dhe klubeve të cillat kontribuojn në përmirësimin e bashkëjetesës në lagje.

### **• *Ju doni të bashkë bisedoni në krijimin e mjedisit të banimit***

Nga ndërtimi i rrugëve, vendeve ose ndërtesave ndryshon qyteti. Kur qyteti ndërton, interesoher aij edhe për dëshirat e popullsisë në vend. Për këtë qyteti e mundëson në disa raste të ashtuquajturën **pjesëmarrje në proces**. Qyteti i Cyrihut e fton popullsin e prekur për pjesëmarrje në proces.

### **• *Ju doni të angazhoheni në shkollën e fëmijëve tuaj***

Në qytetin e Cyrihut bashkëpunojnë shkollat me prindërit e nxënësve. Nëse ju jeni nëne ose baba i një nxënësi, ju mund të angazhoheni për shembull në **këshillin e prindërve** ose ne forumin e prindërve. Çdo shkollë i informon prindërit për këto mundësi.

### **• *Ju doni të jeni pjesëmarrës në vendimet e lagjës***

Në qytetin e Cyrihut janë 25 qendra të lagjës. Këto angazhohen për mbajtjen dhe përmirësimin e kualitetit të jetesës në lagje. Anëtarësimi në një **qëndër të lagjës** është një mundësi e mirë për ju, për të qënë pjesëmarrës në vendimin e nevojave të lagjës. Të gjithë personat e interesum mundën ti bashkohen një qëndër të lagjës.

### **• *Ju e keni një kërkes tek institucionët zyrtare***

Çdo person e ka të drejtën, ti drejtohet një institucioni zyrtar me një lutje, kërkes, sugjerim ose një ankesë. Një menyrë e mundëshme është dorëzimi i një **peticioni**. Për këtë e formuloni kërkesën me shkrim dhe i mbledhni nënshkrimet e personave tjerë të cillët ju mbështesin në peticionin e juaj. Pastaj ju mundëni të dorëzoni peticionin tek institucionët zyrtare adekuate.

- ***Ju doni të angazhoheni së bashku me njëz të cillët mendojn si ju***

Njëzitet me interesat e ngjajshme ose hobit bashkohën në një **klub**, parti, kooperativ ose ndonjë tjetër bashkësie. Këto nuk i mbajnë vetëm takimet, por edhe i përfaqësojnë interesat e anëtarve të tyre. Me anëtarimin e juaj aktiv në një klub, parti ose ndonjë bashkësie tjetër vlerësohet zëri juaj më shumë.

- ***Ju keni nevoj të diskotoni për temën e integritit***

Ju e keni mundësin të drejtoheni me nevojat ose pyetjet e juaja tek institucionet zyrtare adekuate. Në qoftë se pyetja juaj ka të bëjë për integritimin, ju mund të drejtoheni tek zyrat e përkrahjes për integritim të qytetit Cyrih. Kjo së bashku me këshillin e njëzve të huaj të qytetit Cyrih, organizon çdo vit **takime shkëmbimi** me përfaqësuesit dhe përfaqësuesit e organizatave migrante dhe të bashkësive fetare. Në keto takime shkëmbimi ju mund ti shtroni pyetjet e juaj rreth politikëve integruarë dhe nevojave specifike drejtëpërdrejt tek përfaqësuesit dhe përfaqësuesit e qytetit Cyrih.

- ***Ju doni të angazhoheni në këshillin e njëzve të huaj***

Këshilli i njëzve të huaj të qytetit Cyrih ja përcjell këshillit të qytetit dëshirat dhe nevojat e banorve të huaj. **Anëtarët e këshillit** caktohen nga këshilli çdo herë për katër vite. Këshilltarët dhe këshilltarët duhen të banojnë në qytetin Cyrih dhe nuk duhet të kenë shtetësinë zvicerane.

- ***Ju doni të merrni pjesë në referendum***

Që të mund të votoni në nivel federatë, kantonal dhe komunal ju duhet të keni **shtetësinë zvicerane**, si dhe të jeni të moshës madhore dhe të aftë për gjykim. Për shtetësinë ju duhet ti përmbushni disa kushte paraprake. Për keto ju informon departamenti për shtetëzimin e zyrës të qytetit Cyrih.

### **Cillat janë kërkesat gjuhësore për pjesëmarrje në politikë?**

Në përgjithësi të gjithë kanë të drejtën për shprehje, pavarësisht nga njohuritë gjuhësore. Megjithatë përvoja ka treguar, që **njohuritë themelore të gjuhës gjermane** janë të dobishme për pjesëmarrje në politikë. Përkrahja për integritim ju ndihmon në kerkimin e juaj për një **kurs adekuat të gjuhës gjermane**

**Angazhimi juaj është i dëshirueshëm. Informata më të detajuara për mundësit, vendëve për konsultim dhe shembuj praktik i gjeni në web faqën:**

[www.stadt-zuerich.ch/partizipation](http://www.stadt-zuerich.ch/partizipation)